

SKEDË TEKNIKE

RÖFIX 950

Llaç për muratim me bazë çimento-gëlqere M5



Fushat e përdorimit

Llaç muratimi për mure (p. sh. tulle, blloqe betoni, gurë gëlqerorë) me qëndrueshmëri statike normale. Llaç për muratim M5, sipas EN 998-2. Materiale ndërtimi në përputhje me shtojcën A të katalogut ekologjik mbi ndërtesat.

Karakteristikat

- Përpunim i mirë me makineri
- Rendiment i lartë
- Lëvizshmëri e mirë e mistriës (kellengängigkeit)

Përpunimi



Të dhëna teknike

Numri i artikullit	2000152383	36744	10915
EAN	9003304448142	9003304367443	9003304109159
Paketimi			
Sasi për njësi	25 kg/Nj.	30 kg/Nj.	1000 kg/Nj.
Njësi për paletë		42 Nj./Pal	
Madhësia e kokrrizave	0-3 mm		
Udhëzime për përdorimin	Të dhënat mbi konsumin janë orientuese, ato varen shumë nga karakteristikat e bazamentit dhe nga teknika e aplikimit.		
Konsumi i ujit	rreth. 15 L/Nj.	rreth. 18 L/Nj.	rreth. 600 L/t
Prodhimi i litrave	15 L/Nj.	18 L/Nj.	600 L/t
Njësia e kërkesës për ujë	rreth. 3,8 L/Nj.	4,8 L/Nj.	137 L/Nj.
Reaksioni ndaj zjarrit	A1		
Forca në shtypje	$\geq 5 \text{ N/mm}^2$ (28 d) EN 1015-19		
Përcjellshmëria termike	1,11 W/mK për P=50% EN 1745:2002 (Vlera e tabelës) 1,21 W/mK für P=90% EN 1745:2002 (Vlera e tabelës)		
Përmbajtje e kloridit	$\leq 0,1 \text{ M\%}$		
Moduli-E	rreth. 11000 N/mm ²		

RÖFIX 950

Llaç për muratim me bazë çimento-gëlqere M5

Numri i artikullit	2000152383	36744	10915
Qëndrueshmëria fillestare e prerjes	0,15 N/mm ²		
Grup llaçi	M5 EN 998-2 MBL SIA 266 M2 MD ita		
Kapaciteti termik	rreth. 1 kJ/kg K		
Dëndësia në gjëndje të papërpunuar	rreth. 1800 kg/m ³		
Temperatura e nënshtresës	5-30 °C		
Këshilla për paketimin	Në thasë letre me mbrojtje kundër lagështisë.		

Baza e materialit

- Pa përbërës organik
- Rërë gëlqerore e thërrmuar me cilësi të lartë
- Gëlqere e pashuar
- Çimento
- Aditivë për përmirësimin e vetive të përpunimit

Kushtet e punimit

Gjatë fazës së përpunimit dhe tharjes, ambjenti përreth sikurse dhe temperatura e bazamentit nuk duhet të bjerë nën +5 °C dhe të ngrihet mbi +30 °C. Deri sa të arrihet tharja e plotë, mbrojeni nga ngrirja, tharja e shpejtë (rezatimi direkt i diellit, era) dhe shiu.

Bazamenti-Trajtimi paraprak

Tullat e ngrira nuk lejohet të përpunohen. Tullat e thata, me aftësi të lartë thithëse duhet të njomen përpara se të bëhen mur.

Përgatitja

Një thes llaç muri RÖFIX, përziejini në përzierës mekanik ose me rënie të lirë në mënyrë të vazhdueshme, për dy minuta. Nëse përzierja bëhet me mikser me rënie të lirë duhet pasur kujdes që më parë të hidhet uji, pastaj llaçi pluhur

Këshilla për përpunimin

Materialin i hapur më parë nuk duhet përdorur, gjithashtu mos e përzieni me materialin e ri. Llaçin e freskët punojeni brenda 2 orëve.

Përpunimi

Shtrimi i llaçit kryhet me një mistri të pastër ose me slitë llaçi të përshtatshme.

Fugat duhet të mbushen plotësisht mbi të gjithë gjatësinë, thellë dhe të bëhet lidhja e cepave.

Tullat vendosen mbi shtratin e llaçit, duke përdorur nivelin dhe plumçin për vendosjen sa më të drejtë të tyre.

Llaçi që del nga tullat duhet të pastrohet me mistri.

Llaçi për muratim i perzierë dërgohet me kovën e vinçit në vëndin (katin) ku do të aplikohet dhe hidhet në një govatë llaçi.

Llaçi i murit RÖfix përziehet në mënyrën më efektive me “Stacionin përzierës” të llaçit të murit.

Nëse llaçi shtrohet me makinë duhet pasur kujdes konsistenca e përpunimit.

Mbroni tullat dhe llaçin (në veçanti gjatë ndërprerjeve të punës) nga shiu. Shtresa e parë e tullave duhet të vihet horizontalisht me precizion. Pabarazitë duhet të sheshohen në fugën më të poshtme të murit. Sugjerohet kontrolli i konsistencës së përpunimit të llaçit për çdo mbushje të kovës së vinçit. Në rast pushimi, përzierësin duhet ta boshatisni dhe ta pastroni.

ROFIX 950

Llaç për muratim me bazë çimento-gëlqere M5

Këshilla në rast reziku

Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.

Magazinimi

Magazinojeni në vende të thata mundësisht mbi paleta druri. Koha e magazinimit: min. 12 muaj sipas. Rregullores 1907/2006/EG, Aneksi XVII, në temperaturë +20 °C, 65 % lagështi ambjenti.

Certifikatë



Udhëzime teknike dhe ligjore

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skedat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.

Këshilla të përgjithshme

Kjo skedë teknike anullon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme. Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkojnë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme. Ky informacion dhe të dhënat janë përpiluar me kujdes dhe me ndërgjegje të plotë, por pa mbajtur përgjegjësi për vendime ose veprime plotësuese që mund të marrë vetë konsumatori. Të dhënat në vetevete nuk provojnë asnjë lidhje ligjore ose detyrime të tjera anësore, dhe normalisht nuk e ndalojnë konsumatorin të testojë produktin për ato qëllime për të cilat edhe është prodhuar. Produktet ROFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohej një cilësi e pandryshueshme. Stafi ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime

praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona. Skedat tona teknike më të reja, me të dhënat aktuale, mund ti gjeni edhe në faqen tonë të internetit (www.roefix.com), ose mund të kërkojnë edhe pranë filjaleve rajonale në vënd. Normat aktuale kombetare të përdorimit, duhet te merren parasysh. Të gjitha të dhënat teknike të dhëna në këtë fletë produkti janë përcaktuar në kushte laboratorike.